POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1
Zyrtare/ Manchester City prezanton 'Messin e ri'

2
Nëse zgjohesh çdo natë në të njëjtën orë, ndoshta trupi po të dërgon këto sinjale

3
Nuk u dëgjua krisma, oficeri i policisë së Durrësit qëlloi veten me armën e shërbimit në zemër, rreth 6 orë i vdekur në zyrë

4
'Tempulli 2'/ Në kërkim për prodhim dhe shitje kanabisi, në pranga 31-vjeçari në Durrës

5
Fier/ Shoferi humb kontrollin e automjetit dhe del nga rruga, transportohet drejt spitalit

Kronikë

Nënkomisari vetëvritet me armën e shërbimit në zyrë brenda në Komisariatin e Durrësit! U pezullua nga detyra pas dënimit për plagosje

Nënkomisari i policisë së Durrësit Arben Pjeçi u gjet pa jetë në zyrën e tij në Drejtorinë Rajonale. Ishte ora 16:15 e kësaj të enjteje kur kolegët e tij shpërthyen derën dhe e gjetën të pajetë. Prej 34 vitesh në policinë e shtetit u vetëvra pasi mësoi vendimin për lirim nga detyra si i dënuar nga gjykata e Durrësit për plagosje të lehtë, për një konflikti me fqinjin e tij në 2022 për një tendë ballkoni.

- Familja kishte denoncuar humbjen e tij, policia shpërtheu zyrën
- Nuk u dëgjua krisma, oficeri i policisë së Durrësit qëlloi veten me armën e shërbimit në zemër, rreth 6 orë i vdekur në zyrë
- FOTO/ Ky është nënkomisari që u vetëvra, kishte 34 vite në radhët e policisë! Baba i dy fëmijëve
- Në 2022 u zu me grushte me komshiun, ja pse u dënua nga Gjykata
- Nënkomisari prej ditësh në gjendje të rënduar psikologjike

Redaksia
25 Janar, 17:30 | **Përditësimi: 25 Janar, 20:22**

Share

Durrës - Ambientet e komisariatit të Policisë së Durrësit janë kthyer në skenë krimi. Specialisti i Policisë Kriminale, Arben Pjeçi, 56 vjeç, me gradë nënkomisar, është gjetur i vetëvrarë rreth orës 16:15, *(25 janar 2024)* në ambientet e zyrës së punës, në Komisariatin e Policisë Durrës.

Oficeri i policisë kishte më shumë se 6 orë që kishte humbur kontaktet. Familjarët të shqetësuar kishin kërkuar ndihmën e policisë të cilët pasi kanë hapur me forcë zyrën e kanë gjetur të vetëvrarë me armën e shërbimit.

Pjeçi ishte pezulluar nga detyra pas dënimit me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me punë në komunitet për plagosje të lehtë pas një sherri me komshiun dy vjet më parë. Ndërkohë mësohet se prej disa ditësh ishte në gjendje të rënduar psikologjike për shkak të situatës ku ndodhej.



LEXO EDHE:
Operacioni 'Tempulli 2', lihen në burg 35 nga 43 të arrestuarit në Durrës, 1 në arrest shtëpie

Ditët e fundit Pjeçi ishte i shqetësuar pasi e kishte thirrur drejtoria e standardeve për ti komunikuar masën e lirimit nga detyra. 57 vjeçari një efektiv karriere me arsimin në shkollën e policisë të Ministrisë së Brendshme, dhe për vite në shërbim të kufirit ishte emëruar së fundmi në drejtorinë e Durrësit. Babai i dy fëmijëve është vetëvrarë me një plumb në zemër, duke mos pranuar faktin se do largohej nga detyra pas 34 vitesh në radhët e policisë së shtetit.

Ndiqni lajmet në zhvillim...

*Raportuan për Shqiptarja.com gazetarët Artur korriku dhe Aldo Mustafa

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:18

I dha fund jetës pas përjashtimit nga policia e shtetit, efektivi në Durrës kishte mundësi ta ankimonte vendimin brenda 10 ditësh

Lajmi i fundit

Në 2023 Shqipërinë e vizituan 10.1 mln të huaj, ekspertja: Paketat turistike për këtë vit po shtrenjtohen! Turistët e huaj i kombinojnë paketat det, kulturë e histori

25 Janar, 20:46

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Efektivi i Durrrësit Arben Pjeci që i dha fund jetës në komisariat është përjashtuar nga policia e shtetit me firmë të drejtorit të përgjithshëm të policisë Muhamet Rrumbullaku pas vendimit të formës së prerë nga Gjykata për plagosje të lehtë me dashje. Gazetari i Report tv Sokol Dema raporton se ai kishte mundësi ta ankimonte përjashtimin nga policia te Standradet Profesionale në DPPSH brenda 10 ditësh, por nuk e ka shfrytëzuar për ta bërë.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:03

Nuk u dëgjua krisma, oficeri i policisë së Durrësit qëlloi veten me armën e shërbimit në zemër, rreth 6 orë i vdekur në zyrë

Arben Pjeçi oficeri i policisë së Durrësit e ka qëlluar veten me armën e shërbimit në zemër në orën 11:00 të paradites. Duke qenë se krisma nuk është dëgjuar për shkak se e ka puthitur armën në gjoks dhe ka qëlluar veten, 56 vjeçari ka qëndruar rreth 6 orë në zyrë derisa kolegët e tij hapën derën e zyrës me forcë.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:52

Nënkomisari që vrau veten u dënua nga Gjykata për një sherr me grushta me komshiun në 2022, shkak u bë tenda

Specialisti i Policisë Kriminale, Arben Pjeçi i vetëvrarë në ambientet e policisë së Durrësit është dënuar nga Gjykata për plagosje të lehtë me dashje lidhur me një sherr në vitin 2022 me komshiun e tij Kujtim Huqi, ish shofer në polici. Për shkak se Pjeçit i pikonte ballkoni në tendën e Huqit, të dy janë zënë me grushta e shkelma.

Denoncimin në polici e ka bërë komshiu i tij, por efektivi i ndjerë ka deklaruar se vetëm e ka shtyrë Huqin por nuk e ka goditur. Megjithatë Gjykata i ka konsideruar fajtorë të dy për plagosje të lehtë. Por dënimi me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, solli pezullimin e Pjeçi nga detyra dhe më pas vetëvrasjen e oficerit në kushtet e depresionit.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:50

FOTO/ Ky është nënkomisari që u vetëvra në zyrën e tij brenda komisariatit të Durrësit, 34 vite në radhët e policisë së shtetit! Baba i dy fëmijëve

Foto:Arben Pjeçi

Ky është Arben Pjeçi Specialisti i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Durrës, me gradë nënkomisar, që i ka dhënë fund jetës në zyrën e tij me armë e shërbimit. Për një kohë të gjatë ai ka shërbyer si oficer kufiri por më pas ishte transferuar në sektorin e krimeve. Pas 34-vitesh në radhët e policisë së shtetit, efektivi i policisë nuk e ka përballuar mirë vendimin që sillte ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke u vetëvrarë. Ai ishte baba i dy fëmijëve.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:45

Durrës/ I dha fund jetës në zyrën e tij, nënkomisari i dënuar me vendim të formës së prerë për plagosje! Prej ditësh në gjendje të rënduar psikologjike

Specialist i Policisë Kriminale Arben Pjeçi me detyrë nënkomisar që i dha fund jetës ditë sotme në zyrën e tij ishte dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për kundravajtjen penale "Plagosje e lehtë", në bazë të nenit 89 të Kodit Penal. Vendimi ishte konvertuar në 40 orë pune në komunitet. Prej ditësh ai ishte në gjendje të rënduar psikologjike për shkak se ky vendim sillte dhe pezullimin e tij nga detyra.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:40

Polici u vetëvra me armën e shërbimit brenda në komisariat, Policia tregon arsyet

Foto: Arben Pjeçi dhe komisariati i policisë së Durrësit

Policia e Durrësit jep informacion lidhur me ngjarjen e rëndë ku oficeri I policisë Arben Pjeçi është gjetur i vetëvrarë me armën e shërbimit në ambientet e Komisariatit të Policisë Durrës

> *Njoftimi i policise se Durrresit*
>
> *Sot, më datë 25.01.2024, nga ana e familjarëve të oficerit të Policisë Arben Pjeçi, është njoftuar Komisariati i Policisë Durrës, për humbjen e kontakteve me familjarin e tyre, i cili aktualisht është në detyrë specialist i Policisë Kriminale në këtë komisariat.*
>
> *Nga Komisariati i Policisë Durrës filluan veprimet për kërkimin dhe gjetjen e specialistit.*
>
> *Për njoftimin e bërë nga familjarët është marrë kallëzim, është njoftuar prokurori i gatshëm, janë kryer një sërë veprimesh procedurale, si dhe janë vënë në kontroll numrat telefonikë, me qëllim lokalizimin e vendndodhjes së këtij shtetasi.*
>
> *Në kuadër të të gjitha veprimeve operacionale dhe procedurale për kërkimin e tij, rreth orës 16:15, në ambientet e Komisariatit të Policisë Durrës është hapur me forcë zyra e oficerit Policisë Gjyqësore, Arben Pjeçi, i cili është gjetur i vetëvrarë, me armën e shërbimit.*
>
> *Punonjësi i Policisë Arben Pjeçi është dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për kundravajtjen penale "Plagosje e lehtë", në bazë të nenit 89 të Kodit Penal.*
>
> *Vendimi i Gjykatës i formës së prerë ka filluar të ekzekutohet nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit.*
>
> *Punonjësi i Policisë, në kushtet e depresionit për penalitetet që sjell vendimi i dënimit të formës së prerë që e kushtëzonte në të ardhmen me ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Policinë e Shtetit, është vetëvrarë me armën e shërbimit në ambientet e zyrës së punës, në Komisariatin e Policisë Durrës.*
>
> *Për këtë ngjarje është krijuar një grup i posaçëm hetimor, në drejtimin e Prokurorisë së Durrësit dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë.*
>
> *Për këtë ngjarje është njoftuar dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

B.K/Shqiptarja.com

TAG: Durres arben pjeci

Komento

Komente

Toa tao: 25/01/2024 20:36

KU ESHTE TAO LANTI.... 6 ORE I VDEKUR NE ZYRE E ASNJE NUK DIGJON, ASNJE NUK SHEF GJE, ASKUSH NUK FLET, PER 6 ORE ME RADHE..... TAO JEP DORHEQJEN SE ESHTE SKANDAL PER M.BRENCME.... IU PREFT SHPIRTI NE PARAJS.

Përgjigju

The head: 25/01/2024 19:20

Si u pezulloka nje oficer me 34 vjet pune per nje sherr mes komshinjsh ? I keni shkaterruar jeten o plera. Drejtesi te paaftesh, dhe drejtues te paafte. Injorante.

Përgjigju

The bottom: 25/01/2024 20:00

Si perfshihet ne sherr ordiner nje oficer policie me kariere kaq te gjate?OPGJ KA KRYER VETEGJTQESI? Opgj jane fillimi i korupsionit ne sistemin e drejtesise. Ka shkateruar jete njerezish jo te perfshire ne krim pafund.Kaq i dobet psikologjikisht dhe ne ate pozicion dhe per me teper me arme. Kane sherbime psikologike keta oficere policie apo jo?

Beni: 25/01/2024 17:53

Ai gjyqtari qe e ka denu i ka shkatrru jeten duhet var per se gjalli plera! Nuk denojne kriminelet por denojne oficerit e zbatimit te ligjit Kjo eshte e tmerrshme.

Përgjigju

Pipiiii: 25/01/2024 20:25

Kret si puna kti shkoshin..kto Gjakpirsa

Arben: 25/01/2024 19:43

Bravo Bimi! Polici ka qene njeri i dobet dhe kete e ka treguar me kete qe ka bere sot. Shqiperise nuk i duhen keto njerez. Ne na duhen njerez te forte qe durojne shume dhe japin gjithcka per shtetin shqiptar dhe drejtuesit e tij, pa asnje medyshje.

Bimi: 25/01/2024 18:55

Oficer Policie qe perfshihet ne sherr me grushta me komshiun? Duhet denuar dy here me shume se nje qytetar i thjeshte. Nuk eshte faji i gjyqtarit por gjendjes te riu jo te qendrushme emocionale.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Operacioni 'Tempulli 2', a po godet Policia shpërndarjen e lëndëve narkotike?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera



‘Tempulli 2’/ Në kërkim për prodhim dhe shitje kanabisi, në pranga 31-vjeçari në Durrës

25 Janar, 09:51

11 raste me fruth në Shqipëri, drejtoresha e ISHP Tomini për Report Tv: Të infektuarit janë 1-13 vjeç! Shpërndarja në tre qytete, si paraqitet situata

Ledina Jakimi

24 Janar, 16:21

Fruthi konfirmohet në Shqipëri, burime nga ISHP: 11 raste në Tiranë e Durrës

Ledina Jakimi

24 Janar, 11:56

U plagos dje në fshatin Krujë, 42-vjeçari arrestohet nga SPAK në spitalin e Traumës! Ishte në kërkim

23 Janar, 13:24



‘Tempulli 2’/ 52 të arrestuar në Durrës, sekuestrohet kanabis, kokainë, armë e gati 16 mijë euro

23 Janar, 10:21

Begaj viziton anijen ushtarake të Marinës britanike pranë Durrësit

22 Janar, 17:24

Krujë/ Plagoset me armë zjarri 42 vjeçari në fshatin Bru Zallë, transportohet drejt Traumës për shkak të hemorragjisë! Policia në kërkim të autorit (EMRAT)

22 Janar, 14:13

Operacioni antidrogë, 67 të arrestuar në Durrës! Kapen me doza kanabisi

22 Janar, 10:32

‘Tempulli 2’/ Operacion antidrogë në gjithë vendin, goditen 7 grupe kriminale! 273 të arrestuar në Tiranë e 5 qytete! Sekuestrohen mbi 567 kg drogë, armë e valutë

Sokol Dema

22 Janar, 07:14

Në Porto Romano është thyer embargo me Rusinë

Anila Hoxha

21 Janar, 10:48

Fushë-Krujë/ Dalja e lumit Ishëm nga shtrati, qindra hektarë tokë bujqësore ende nën ujë

21 Janar, 09:23

Begaj takim me sipërmarrës në Shijak: Investimet e ndershme zhvillojnë Shqipërinë

20 Janar, 11:49

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje